

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët: Vahid Halili, kryetar, Fillim Skoro e Abdullah Ahmeti, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Shaqë Curri, si procesmbajtës, në lëndën penale të akuzuarit J.M, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike, nga neni 229 par.2 lidhur me par.4 nën par.3 të KPK, duke vendosur përkritazi me ankesën e të akuzuarit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Pejë, PKR.P.nr.62/2015, të dt.23.10.2015, në seancën publike të kolegjit e mbajtur me dt.29.02.2016, morri këtë:

### AKTGJYKIM

Me aprovimin e ankesës të akuzuarit J.M, e sipas detyrës zyrtare aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Pejë, PKR.P.nr.62/2015, të dt.23.10.2015, ndryshohet përkritazi me cilësimin juridik të veprës penale , ashtu që Gjykata e Apelit, gjen se në veprimet e të akuzuarit J.M, formohen elementet e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, të rrezikshëm dhe substancave psikotropike, nga neni 229 par.1 të KPK, në pjesët tjera aktgjykimi mbetet i paprekur.

### Arsyetim

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore-DKR në Pejë, PKR.P.nr. 62/2015, të dt.23.10.2015 të akuzuarin J.M, e ka shpallur fajtor për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike, nga neni 229 par.2 lidhur me par.4 nën par.3 të KPK dhe është gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 250(dyqindpesëdhjetë)Euro dhe me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1(një)viti, e në të cilin dënim do të i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.28.03.2012, gjerë me dt.08.06.2012, të cilat dënime do të ekzekutohen pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga i akuzuari është bërë konfiskimi i substancës narkotike, në sasi prej 45.88gr. si mjet me të cilin është kryer vepra penale, ndërsa i akuzuari është liruar nga shpenzimet e procedurës penale.

Kundër këtij, aktgjykimi me kohë ankesë ka ushtruar:

-I akuzuari J.M., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimin mbi dënimin, me propozim që ankesa e të akuzuarit të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja penale të kthehet në rigjykim ose të lirohet nga dënimi.

Prokuroria e Apelit-DKR në Prishtinë, me shkresën e saj, PPA/I.nr.595/2015, të datës 28.12.2015, duke u sqaruar përkritazi me ankesën e të akuzuarit, ka propozuar që ankesa e të akuzuarit J.M, të refuzohet si e pabazuar dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, konformë nenit 390 par.1 të KPP, ka caktuar seancën e kolegjit në të cilën morën pjesë i akuzuari J.M., ndërsa munguan Prokurori i Apelit-DKR në Prishtinë dhe

mbrojtësi i të akuzuarit edhe pse nga seanca e kolegjit të dt.22.02.2016, ishin njoftuar me rregull për seancën e dt.22.02.2016, të njëjtin nuk kanë marrë pjesë edhe pse ishin njoftuar në mënyrë të rregullt dhe seanca është mbajtur në mungesë të tyre, për arsye se pjesëmarrja e tyre nuk është e domosdoshme e në bazë të nenit 394 par.4 të KPP.

Gjykata e Apelit, në seancën publike të kolegjit të mbajtur, shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, e sipas detyrës zyrtare dhe sipas pretendimeve ankimore, në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPP, shqyrtoj pretendimet ankimore të akuzuarit dhe aktgjykimin e ankimuar, si dhe sqarimin me shkrim të Prokurorisë së Apelit-DKR në Prishtinë, dhe pas vlerësimit të propozimeve të paraqitura në ankesa dhe shkresave tjera të lëndës, gjeti se:

Përkitazi me ankesën e të akuzuarit J.M., ndryshohet aktgjykimi vetëm sa i përket cilësimit juridik të veprës penale.

I akuzuari në ankesën e tij, pretendon se gjykata nuk ka vlerësuar faktet relevante, e të dëshmitarëve A.K, A.B, A.L1, A.L2, A.A, D.B, D.H, e Z.T, se dëshmitë e këtyre dëshmitarëve janë të sakta, dhe gjykata dëshmitë e dëshmitarëve si prova nuk i ka mbështetur, kjo për arsye se nëse dëshmitarët në rrethin ku kanë ekzistuar kamerat kam qenë i përcjellë, nga këto prova nuk mund të vërtetohet qëllimi që të dërgoj narkotik te i burgosuri duke i dhënë atë narkotik dhe asnjë mënyrë i burgosuri nuk mundet të mbetet anonim.

Si pasoj e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale të cekura më lartë ankesa pretendon se është shkelur edhe ligji penal nga neni 385 par.1 të KPP. për arsye se gjykata nuk ka gjet elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtorë vendimin e ka mbështetur në deponimet e dëshmitarëve, pa e vërtetuar qëllimin se ku kam pas për ta dërguar narkotikun dhe i burgosuri ka mbetur anonim, dhe nga kjo del se është shkelur ligji penal.

Në ankesë pretendohet se edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, kjo për arsye se unë narkotikun e kam gjetur në tokë dhe ja u kam dhënë, edhe pse qëllimi im ka qenë që ta dërgoj te komandanti i pavijonit për arsye se aty nuk kam gjetur vetëm narkotik por edhe një bateri telefoni, dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është marrë me vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese të parapa si nenin 64 të KPK, kjo për arsye se narkotikun nuk e kam sjell nga jashtë por narkotiku është gjetur brenda rrethit të burgut e për këtë arsye edhe dënimi është i lartë, për arsye se gjykata nuk ka vërtetuar gjendjen faktike ka shkelur ligjin penal dhe aktgjykimi është marr për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Gjykata e Apelit, duke vlerësuar pretendimet ankimore të cekura në ankesë, vlerëson se dispozitivi i aktgjykimit, është i qartë, i kuptueshëm dhe nuk ekzistojnë kundërthënie në mes të dispozitivit të aktgjykimit dhe me arsyet e paraqitura në arsyetimin e aktgjykimit. Gjykata e shkallës së parë, ka paraqitur arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare rreth argumentimit të kryerjes së veprës penale nga ana e të akuzuarit J.M.. Në dispozitiv të aktgjykimit janë paraqitur të gjitha faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale, se i akuzuari me dt.28.03.2012, i cili ishte përfshirë në planin vëzhgues në qendrën e paraburgimit në Dubravë, e me përcjelljet e veprimeve të akuzuarit J.M., nga ana e dëshmitarëve A.K, A. LI, D.B, A.B1, D.H, A.L, A.A dhe A.B2, pasi që është ndalur gjatë kontrollit të tij, me qëllim shitje, te i akuzuari janë gjetur substanca narkotike të llojit marihuan në sasi prej 45.88gr. e cila ishte e paketuar në një pako të cigareve.

Gjykata e Apelit, vlerëson se rreth argumentimit të kryerjes së veprës penale, nga ana e të akuzuarit J.M., vërtetohen dhe mbështeten nga dëshmitë e dëshmitarëve, A.K, Z.T, A.LI, D.B, A.L, A.A e D.H, të dhëna në shqyrtimin gjyqësor e të cilët në dëshmitë e tyre deklarojnë se te i akuzuari J.M., pas kontrollit është gjetur pija narkotike e llojit marihuan në sasi prej 45.88 gr. dhe gjykata e shkallës së parë, jep arsye të mjaftueshme dhe të qarta, dhe nga provat e nxjerra në shqyrtimin

gjqësor drejt konkludon se i akuzuari ka kryer veprën penale e nga kjo rezulton se aktgjykimi nuk është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara në ankesën e të akzuarit J.M., nga neni 384 par. 1 të KPP.

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet ankimore të paraqitura në ankesë, se gjykata e shkallës së parë, nuk ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike janë të pabazuara. Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike nga provat materiale, e kjo argumentohet se nga kamerat e vendosura në Burgun e Dubravës, në pavionin nr.IV, dhe nga dëshmitë e dëshmitarëve A.K, Z.T, A.LI, D.B, A.L, A.A e D.H, të dhëna në shqyrtimin gjyqësor, gjatë kontrollit të i akuzuari, është gjetur substancë narkotike – marihuan në sasi prej 45.88 gr. e pakeluar në një pako të cigareve, e kjo mbështetet edhe nga ekspertiza e Agjencionit të Kosovës për Forenzikë, e që rezulton se substanca narkotike e cila pas kontrollit është gjetur te i akuzuari J.M, nga oficerët e burgut të Dubravës, është e llojit kanabisë, që përmban tetrahidrokanabinoll, në peshë të përgjithshme, prej 45.88gr. nga kjo del qartë se gjykata e shkallës së parë, nga provat e nxjerra në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila është e pranueshme edhe për Gjykatën e Apelit.

Gjykata e Apelit, duke e vlerësuar aktgjykimin e animuare konformë dispozitës së nenit 394 par.1 të KPP, në kuptim të dispozitës së nenit 385 par.1 të KPP, që ka të bëjë me shkelje të ligjit, gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është përfshirë në shkelje të ligjit penal.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë nuk ka aplikuar drejt ligjin penal nga neni 385 par1, nën par 1.4, kjo për arsye se për veprën penale për të cilën është gjykuar i akuzuari J.M., është zbatuar ligji i cili nuk mundë të zbatohet. Nga përshkrimi faktik i veprës penale, objekti i aktgjykimin të ankimuar rrjedh se për ekzistimin e blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike, nga neni 229 par.2 lidhur me par.4 nën par.3 të KPK, vepra penale nga par.2 duhet të jetë vepër e kryer tërësisht dhe përfshinë veprimet inkriminuese të shpërndarjes, shitjes, transportimit, dorëzimit, ndërmjetësimit, të substancave narkotike të shpallura me ligji të rrezikshme. Në këtë çështje penale sipas Gjykatës së Apelit, nga përshkrimi faktik i veprës penale të i akuzuari me dt.28.03.2013, pasi që është kontrolluar është gjetur substanca narkotike në sasi prej 45.88 gr. e llojit marihuan, dhe nga i njëjti përshkrim faktik nuk jep të konkludohet se i akuzuari ka pasur qëllim kryerjen e veprës penale si parasheh dispozita e nenit 229 par.2 të KPK, shpërndarjen, shitjen, transportimin, dorëzimin, ndërmjetësimin e substancës narkotike e të cilët narkotik janë të shpallura me ligj të rrezikshme, dhe në veprimet e të akzuarit, nuk kemi elemente qenësore të veprës penale, nga neni 229 par.2 të KPK, për arsye se nga përshkrimi faktik të i akuzuari, gjatë kontrollit janë gjetur 45.88 gr. të pakeluar në një pako të cigareve narkotik të llojit marihuan e me qëllim që kushdo që pa autorizim blen ose posedon me qëllim të shitjes [...], pra nuk kemi elementin e drejtpërdrejt të veprimeve komulative inkriminuese për kryerjen e veprës penale dhe për këtë arsye e ndryshoi cilësimin juridik të veprës penale nga neni 229 par.2 lidhur me par.4 nën par.3 të KPK në veprën penale nga neni 229 par.1 lidhur me par.4 nën par.3 të KPK.

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të paraqitura në ankesë nga i akuzuari J.M, lidhur me sanksionet penale janë të pabazuara, kjo për arsye se i akuzuari në ankesën e tij nuk cek asnjë arsye për zbutjen e dënimit, dhe gjykata e shkallës së parë, gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin dhe matjen e saj ka vlerësuar drejtë të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat i aprovon edhe kjo gjykatë e pa vlerësimin e rrethanës se kemi të bëjmë me person zyrtar dhe për këtë vepra penale sipas dispozitës së nenit 229 par.2 lidhur me par.4 nën par.3 të KPK e për të cilën vepër ka qenë i akuzuari i akuzuari J.M., parashihet dënimi me gjobë dhe me burgim pre 3(tre) deri në 15(pesëmbëdhjetë) vjet, edhe përkundër ri cilësimit të veprës penale, dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, dhe i zbutur, është në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akzuarit dhe me dënimin e

shqiptuar me gjobë në shumë prej 250(dyqindpesëdhjetë)euro, dhe me dënimin e shqiptuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, e në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i parapa si nenin 41 të KPRK.

Nga kjo që u cekë më lartë u deshtë që ankesa e të akuzuarit te refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet, e në bazë të nenit 401 të KPP.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.627/2015, me dt.29.02.2016**

**Procesmbajtësi,**

\_\_\_\_\_  
**Shaqë Curri**

**Anëtarët e Kolegjit,**

\_\_\_\_\_  
**Fillim Skoro**

\_\_\_\_\_  
**Abdullah Ahmeti**

**Kryetari i Kolegjit,**

\_\_\_\_\_  
**Vahid Halili**